



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 02.02.2026

MBLEDHJA Nr. 06,
Datë 04.02.2026, ora 11:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 04.02.2026, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 06, e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Tirana International Development” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
3. Mbi konfidencialitetin e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. në kuadër të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.
5. Mbi fillimin e procedurës për marrjen e masave administrative ndaj subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2025 të pashlyera ndaj ERE-s.
6. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI